

LIGJ
Nr. 76/2018

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI PËR HAPJEN
E PIKËS SË PËRBASHKËT TË KALIMIT KUFITAR ZOGAJ (REPUBLIKA E
SHQIPËRISË)–SKJE (MALI I ZI), PËR QARKULLIMIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR
DHE TË PASAGJERËVE NË LIQENIN E SHKODRËS**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë)–Skje (Mali i Zi), për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në liqenin e Shkodrës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.
Miratuar në datën 1.11.2018

Shpallur me dekretin nr. 10942, datë 9.11.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË MALIT TË ZI PËR HAPJEN E PIKËS SË PËRBASHKËT TË KALIMIT
KUFITAR ZOGAJ (REPUBLIKA E SHQIPËRISË)–SKJE (MALI I ZI), PËR QARKULLIMIN
NDËRKOMBËTAR RRUGOR DHE TË PASAGJERËVE NË LIQENIN E SHKODRËS**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Malit të Zi (në vijim të referuara si “Palët Nënshkruese”),

duke u nisur nga marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe miqësore, si dhe bashkëpunimi ndërmjet dy shteteve;

duke pasur parasysh mundësitë reale për fuqizimin dhe për përmirësimin e mëtejshëm të bashkëpunimit të barabartë dhe fitimprurës të dyanshëm dhe afatgjatë, si dhe dëshirën e tyre për të krijuar kushte optimale për zhvillimin e këtij bashkëpunimi;

duke zbatuar vendimet për përmirësimin e infrastrukturës rajonale dhe evropiane të transportit, si dhe legjislacionin dhe standardet e Bashkimit Evropian, vendimin (BE) 2016/399 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 9 mars 2016, për Kodin e Rregulloreve të Bashkimit për lëvizjen e personave në kufi, në pjesën e lidhur me kalimet kufitare dhe kontrollin e kalimit të kufirit shtetëror;

me dëshirën për të përmirësuar lëvizjen e shtetasve midis dy shteteve dhe për të lehtësuar qarkullimin në kufirin e përbashkët shtetëror,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Qarkullimi i personave dhe tregtia e mallrave përmes kufirit shtetëror

Neni 1

Qarkullimi i personave dhe i mallrave përmes kufirit shtetëror ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Malit të Zi lejohet vetëm në pikat e kalimit kufitar për qarkullimin ndërkombëtar ose në vendet e tjera sipas marrëveshjeve të lidhura ndërmjet Palëve Nënshkruese.

Palët nënshkruese do të mbyllin të gjitha vendndodhjet, të cilat nuk parashikohen nga paragrafi 1 i këtij neni me anë të mjeteve të mjaftueshme dhe të kontrollit të duhur, ku do të njoftojnë shtetasit në kohën e duhur.

Hapja e pikës së kalimit të përbashkët kufitar

Neni 2

Palët nënshkruese, në kufirin e përbashkët shtetëror hapin një pikë të përbashkët të kalimit kufitar për trafikun ndërkombëtar tokësor dhe të pasagjerëve në Liqenin e Shkodrës, Zogaj (Republika e Shqipërisë)—Skje (Mali i Zi), (në vijim “pika e përbashkët e kalimit kufitar”).

Pika e përbashkët e kalimit kufitar do të ndërtohet në territorin e Malit të Zi, në vendin e emërtuar, Skje, në rrugën Bar—Ostros—Shirokës—Shkodër.

Vendndodhja e pikës së përbashkët të kalimit kufitar dhe parametrat e saj teknikë do të përcaktohen nga Palët Nënshkruese.

Pika e përbashkët e kalimit kufitar për trafikun ndërkombëtar rrugor të pasagjerëve është i hapur 24 orë në ditë për qarkullim të pasagjerëve.

Pika e kalimit të përbashkët kufitar

Neni 3

Pika e kalimit të përbashkët kufitar është një kalim kufitar ku shërbimet kufitare të palëve realizohen njëra pas tjetrës, me një ndalesë, me harmonizimin e procedurave, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe me këtë marrëveshje dypalëshe, me synim përshejtimin e qarkullimit përmes kufirit të përbashkët shtetëror, thjeshtimin e procedurave kufitare, përdorimin në mënyrë më racionale të burimeve dhe bashkëpunimit më të suksesshëm të shërbimeve kufitare.

Protokolli për zbatimin e marrëveshjes

Neni 4

Palët nënshkruese bien dakord të nënshkruajnë, në përputhje me këtë marrëveshje, një protokoll për zbatimin e saj, i cili do të përcaktojë procedurat për realizimin e kontrollit të përbashkët kufitar, çështjet teknike dhe financiare të lidhura me ndërtimin dhe funksionimin e pikës së përbashkët të kalimit kufitar.

Monitorimi i zbatimit të kësaj marrëveshjeje

Neni 5

Monitorimi i zbatimit të dispozitave të kësaj marrëveshjeje do të kryhet nga Komisioni i Përbashkët i ekspertëve, i krijuar në bazë të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi, për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Muriqan—Sukobinë, të nënshkruar në datën 17 janar 2007, që është, gjithashtu, përgjegjës për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Detyrat dhe mënyra e punës së Komisionit të Përbashkët të ekspertëve

Neni 6

Detyrat kryesore të Komisionit të Përbashkët të Ekspertëve janë:

- a) Të monitorojë zbatimin e marrëveshjes dhe të drejtojnë procedurën e kryerjes së kontrollit të përbashkët kufitar.
- b) Të monitorojë dhe të analizojë shkallën e shpeshtësisë së kalimeve kufitare dhe të propozojë masa dhe veprime për përsheptim të qarkullimit të personave dhe mallrave;
- c) Të shqyrtojë dhe të zgjidhë të gjitha çështjet e rëndësishme për zbatimin e marrëveshjes;
- d) T'i dorëzojë organeve kompetente të Palëve Nënshkruese një propozim për amendimin e marrëveshjes dhe të propozojë marrjen e masave për të përmirësuar kushtet e zbatimit të saj.

Komisioni i Përbashkët i Ekspertëve do të takohet dhe do të punojë sipas nevojës së përcaktuar dhe të paktën një herë në tre muaj, në mënyrë të alternuar, në territorin e secilës Palë Nënshkruese.

Përgjashtimi nga taksat dhe sigurimi i asistencës

Neni 7

Sendet dhe mjetet e transportit të nevojshme për funksionimin e pikës së përbashkët të kalimit kufitar përjashtohen nga pagesa e taksave, tatimet e importit dhe eksportit.

Autoritet kompetente të Palëve Nënshkruese u ofrojnë punonjësve në pikën e përbashkët të kalimit kufitar ndihmën e duhur për akomodimin, mjetet e transportit dhe krijimin e lidhjes me autoritetet e tyre.

Vlefshmëria

Neni 8

Marrëveshja lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe.

Secila Palë Nënshkruese mund ta ndërpresë Marrëveshjen, duke dërguar njoftim me shkrim nëpërmjet rrugëve diplomatike. Në këtë rast, kjo marrëveshje do të pushojë së zbatuari gjashtë muaj pas datës në të cilën Pala tjetër nënshkruese ka marrë njoftimin për ndërprerjen e marrëveshjes.

Hyrja në fuqi

Neni 9

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike, duke njoftuar njëra-tjetrën për përmbushjen e procedurave të tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

Nënshkruar në Shkodër, në datën 3 korrik 2018, në dy origjinale, në gjuhët shqipe, malazeze dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëllëj autentike.

Në rast mosmarrëveshjeje në interpretimin e marrëveshjes, teksti në gjuhën angleze ka përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Fatmir Xhafaj

Ministër i Brendshëm

PËR QEVERINË E MALIT TË ZI

Mevludin Nuhodžić

Ministër i Brendshëm